

Shejkhun i nderuar
Salih ibn Feuzan el Feuzan

Shpjegimi i

Gjashtë

Parimeve

شرح

الأصول الستة

Titulli në origjinal: شرح الأصول الستة

Autor: *Shejkhul Islam Muhamed ibn AbdulUehab*

Shpjegoi: *Shejkh Salih ibn Feuzan el Feuzan*

Përktheu: *Fatjon Isufi*

Kontrolloi: *Shuajb Rexha*

Faqosja dhe kopertina: *Rajan Alliu*

Boton

Qendra Islame “Udha e Besimtarëve” ©

www.udhaebesimtareve.com

Tiranë 2014

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



Parathënie

Nga gjërat më të çuditshme dhe nga argumentet më të mëdha që tregojnë për fuqinë e Sunduesit të Gjithëpushtetshëm janë këto gjashtë parime që i përmendi Allahu i Lartësuar (në Kuran) shumë qartë për të gjithë njerëzit, qartësi që hedh poshtë supozimet e supozuesve. E megjithatë shumë njerëz të zgjuar gabuan në këtë, me përjashtim të një pakice shumë të vogël.

Falënderimet janë vetëm për Allahun Zotin e botrave, paqja nderimet dhe lëvdatat janë për të dërguarin tonë Muhamedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij.

Nuk ka dyshim se Allahu i Madhëruar e zbriti Kuranin sqarues për çdo gjë. Edhe Profeti, alejhis-salatu ue selam, e sqaroi (komentoi) Kuranin në mënyrën më të mirë.

Prej gjërave më të mëdha që ka sqaruar Allahu dhe i dërguari i tij në këtë Kuran, është çëshjta e teuhidit dhe e shirkut. Sepse teuhidi është baza e Islamit dhe e fesë dhe mbi të ndërtohen të gjitha punët.

Nga ana tjetër shirku e shkatërron këtë bazë dhe e prish atë, dukuri e cila nuk duhet të ekzistojë, sepse teuhidi dhe shirku janë dy gjëra të kundërta që kurrë nuk mund të bëhen bashkë.

Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar e sqaroi këtë bazë në të gjithë librin e tij dhe pothuajse nuk gjen ndonjë sure që nuk përmend teuhidin dhe shirkun. Ndërkohë njerëzit e lexojnë dhe e përsërisin shpesh herë Kuranin, por pak prej tyre i kushtojnë vëmendje kësaj baze.

Shumë njerëz e lexojnë Kuranin dhe nga ana tjetër bien në shirk, apo lënë mangut teuhidin, edhe pse kjo çështje është shumë e qartë në librin e Allahut dhe në Sunetin e Profetit, alejhis-salatu ue selam.

Kjo ndodh sepse këta njerëz ecin sipas zakoneve dhe fesë në të cilën gjetën baballarët dhe hoxhallarët e tyre. Pra tek ata primare është feja në të cilën gjetën baballarët, hoxhallarët dhe njerëzit e atij vendi, dhe nuk mendojnë qoftë dhe për një çast në kuptimin e ajeteve kuranore për t'i ballafaquar veprimet që bëjnë njerëzit, a përputhen me Kuranin apo jo?

Në fakt ndodh e kundërta, sepse ndjekja e verbër e baballarëve i çoi ata të mendonin se leximi i Kuranit bëhet vetëm për bereqet dhe për të marrë shpërblime dhe jo për të medituar, apo për të punuar sipas tij. Pak njerëz e lexojnë Kuranin për këtë qëllim, shumë prej tyre e lexojnë për bereqet, apo për të shijuar bukurinë e leximit të ndonjë lexuesi, ose e lexojnë për ndonjë të sëmurë për ta kuruar.

Por që të lexohet për të punuar me të dhe për ta medituar, apo që veprat e njerëzve t'i ballafaqojnë me të, kjo nuk ndodh vetëm se me një grup të vogël njerëzish, nuk themi nuk ekziston, por themi se është gjë shumë e rrallë.

Për këtë arsye Kuranin e sheh në një anë dhe veprat e njerëzve i sheh në anën tjetër dhe nuk u shkon mendja të ndryshojnë asnjëherë. Madje edhe nëse

dikush prej njerëzve të ditur, apo rinovues mundohet të ndryshojë gjendjen e njerëzve ata ngrihen kundër tij dhe e akuzojnë si njeri të humbur, të dalë nga feja dhe se po sjell një fe të re, etj etj.

Kjo gjë i ka ndodhur edhe autorit të këtyre parimeve në kohën kur bëri përpjekje për t'i kthyer njerëzit tek Kurani dhe gjërat që tregon Kurani, për të ndryshuar ato zakone të kota, ata i dolën kundër, ku disa prej tyre (kundërshtarët) e quajtën mëkatar, e disa të tjerë e quanin bidatçi, madje disa e konsideronin të dalë nga feja Islame.

Por kjo nuk prish punë dhe nuk është e çuditshme, sepse profetëve u kanë thënë gjëra më të ulëta se këto. Profetët e Allahut kur deshën të ndryshonin adhurimin që bënë njerëzit ndaj zotave të tjerë në vend të Allahut, njerëzit thanë për ta ato që thanë, e si mos t'u ndodhë kjo gjë thirrësve dhe dijetarëve? Pra nuk është për tu çuditur dhe kjo nuk ia ul vlerën dijetarit apo thirrësit përkundrazi, kjo ia shton sevapet tek Allahu i Madhëruar.

Në fakt kjo konsiderohet ulje për atë që flet dhe shkruan, kjo e metë i kthehet atij, ndërsa dijetarëve të sinqertë dhe thirrësve tek Allahu nuk i dëmton, përkundrazi u shton gradat dhe sevapet. Ata kanë

shembullin më të mirë tek profetët për ato që janë ofenduar dhe i kanë akuzuar. Allahu i Madhëruar i thotë Profetit, alejhis-salatu ue selam:

“Ty nuk po të thuhet tjetër përveç asaj që u është thënë të dërguarve para teje. Vërtet, Zoti yt është ai që falë, por është edhe Ai që ndëshkon rëndë.”
Fusilet 43.

Shejhu në fjalët e mëposhtme do të sqarojë një pjesë të kësaj çudie se si njerëzit e lexojnë Kuranin, madje lexojnë shumë, i bëjnë hatme¹, e mësojnë përmendësh, u kushtojnë rëndësi shkronjave, texhvidit dispozitave të medit, idgamit, gunes, iklabit, idhharit dhe ihfas², pra kësaj i kushtojnë shumë rëndësi dhe kjo është gjë e mirë, por duhet ditur se qëllimi final është meditim i fjalëve të tij (Kuranit), marrja e dijes prej tij dhe ballafaqimi i veprave tona dhe të njerëzve me librin e Allahut, a janë në përputhje me të apo janë në kundërshtim me të.

Kjo kërkohet nga ne, të përmirësojmë gjendjen tonë, të tregojmë ku gabojnë njerëzit, jo me qëllimin që t'i turpërojmë ata, apo që të hakmerremi ndaj tyre, por me qëllim përmirësimin dhe këshillimin.

¹ Leximi i tërë Kuranit.

² Të gjitha këto janë rregulla të leximit të Kuranit.

Autori Shejkhul Islam Muhamed ibn AbdulUehab thotë:

Parimi i parë:

Përmban sinqeritetin e fesë vetëm për Allahun e Madhëruar, të vetëm e të pashok dhe sqarimi i asaj që bie ndesh me të, i cili është shirku. Si dhe sqarimin e plotë rreth faktit se shumica e ajeteve Kuranore sqarojnë këtë parim në forma të ndryshme dhe me fjalë të cilat i kupton edhe njeriu më i thjeshtë.

Shpjeguesi: Parimi i parë i këtyre gjashtë bazave përmban sinqeritetin e fesë vetëm për Allahun të vetëm e të pashok. Ky është parimi i të gjitha parimeve dhe baza e fesë, rreth këtij parimi ndodhi përballja mes profetëve dhe popujve të tyre. Profetët kërkonin të saktësonin këtë parim për të cilin Allahu i krijoi njerëzit dhe lumturinë e tyre e lidhi ngushtë me praktikimin e tij.

Nuk është me rëndësi që njeriu të shtojë namazin, agjërimin apo adhurimet, i rëndësishëm në këtë rast është sinqeriteti. Pak adhurim me siqeritet, është më i mirë se shumë adhurim pa sinqeritet. Nëse njeriu do të falej natën dhe ditën, do të jepte nga

pasuria e tij dhe do të bënte punë të ndryshme pa sinqeritet, adhurimi i tij do të ishte i pavlerë, sepse sinqeriteti është i domosdoshëm.

Kuptimi i sinqeritetit është: Braktisja e shirkut dhe njëhsimi i Allahut të madhëruar në adhurime. Askush nuk meriton të adhurohet, sado i përkryer dhe sado i mirë qoftë, përveç Allahut, të Përsosurit absolut. Kushdo qofshin ata që adhurohen: engjëj të afërt tek Allahu, profetë dhe të dërguar, njerëz të mirë apo të dashur tek Allahu, nuk u takon asgjë nga adhurimi. Kjo është baza, që nuk mund të realizohet pa lënë shirkun. Ai që përzien mes shirkut dhe adhurimit, puna e tij është e shkatërruar, ndërsa ai që punën e bën vetëm për Allahun, ai është fatlumi edhe nëse punët e tij janë të pakta, sepse pak punë me sinqeritet kanë hajër dhe shpëtim. Ndërkohë që hadithi i fletës është mëse i njohur:

“Allahu i Madhëruar do e marrë në pyetje para gjithë njerëzve një njeri prej umetit tim. Para tij do të paraqiten nëntëdhjetë e nëntë libra dhe secili prej tyre është aq i madh sa të arrijë shikimi i tij. Më pas, Allahu i Madhëruar thotë: “A mendon se të kanë bërë padrejtësi engjëjt që shkruanin veprat e tua?” Njeriu përgjigjet: “Jo o Zoti im.” Allahu vazhdon: “A ke ndonjë arsyetim? Thotë:

“Jo, o Zoti im.” Atëherë Allahu i thotë: “Ti posedon tek Ne një të mirë dhe kurrësi nuk do të bëhet padrejtësi.” Në këtë moment do t’i tregojnë një fletë ku shkruhet: “Eshhedu en la ilahe ila Allah ue eshhedu ene Muhameden abduhu ue rasuluhu.”³ I thuhet: “Sille peshoren tënde!” Njeriu thotë: “O Zoti im! Çfarë është kjo letër në krahasim me këto libra?!” Allahu përgjigjet: “Ty nuk do të bëhet padrejtësi.” Pastaj vendoset letra në një anë të peshores dhe librat në anën tjetër dhe papritur letra e fluturon lartë krahun e librave”.

Pra me emrin e Allahut, asnjë peshore nuk mund të krahasohet.

Ky pra është sinqeriteti, sepse ai nuk e tha thjesht si një fjalë, përkundrazi e tha duke e ditur kuptimin e saj, duke besuar në të dhe në gjërat që ajo kërkon, por që ndërroi jetë para se të punonte. Atëherë si mund të qëndrojë puna me atë që ka bërë shumë punë të sinqerta vetëm për Allahun?!

Kjo tregon se sinqeriteti edhe pse i pakët e shpëton njeriun, ia shlyen mëkatet e të këqiat, ndërsa nëse

³ Dëshmoj se askush nuk meriton të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

nuk ka shqeritet atëherë nuk kanë dobi punët e mëdha.

Autori: Sqarimi i asaj që bie ndesh me të, i cili është shirku

Shpjeguesi: E kundërta e teuhidit është Shirku ndaj Allahut. Teuhidi është njësimi i Allahut në adhurim, ndërsa shirku është t'ia drejtosh adhurimet dikujt tjetër në vend të Allahut, siç është kurban, zotimi, dua dhe kërkitimi i ndihmës, e shumë adhurime të tjera. Ky pra është shirku dhe qëllimi është shirku në adhurim, sepse shirku në rububijet në përgjithësi nuk ekziston.

Të gjithë popujt e pranojnë domosdoshmërisht njësimin e Allahut në rububije dhe këtë nuk e ka mohuar vetëm se ai që ka shfaqur kundërshtim të jashtëm, edhe pse në brendësinë e tij e pranon atë. Atëherë pranimi i këtij teuhidi është i domosdoshëm, sepse të gjithë e dinë se ky krijim dhe ky univers ka vetëm një krijues dhe këto krijesa që ecin mbi tokë patjetër kanë mbikqyrës që kujdeset, pra nuk është ekzistencë e rastësishme, apo që është krijuar vetvetiu, Allahu i Madhëruar thotë:

“A mos u krijuan prej asgjësë, apo ata vetë janë krijues? A mos ata i krijuan qiejt e tokën? Jo, por ata nuk janë të bindur.” Tur 35-36.

Pranimi i teuhidit rububije është pranim i domosdoshëm dhe natyral, por nuk është i mjaftueshëm, nuk u mjaftoi mushrikëve ky lloj teuhidi edhe pse e pranuan. Allahu i madhëruar në Kuranin fisnik kur flet për këtë qartazi thotë: **“Po nëse ti i pyet: Kush i krijoi ata?”** Çfarë përgjigje do të japin? Do të thonë Allahu. Pra, Allahu na krijoi dhe ky është teuhidi rububije⁴.

Ajo që kërkohet në fakt është teuhidi uluhije, sepse këtu kanë ndodhur kundërshtimet dhe mospajtimet mes profetëve dhe popujve të tyre, mes thirrësve në rrugën e Allahut dhe njerëzve, pra për këtë teuhid ndodhin konfliktet dhe mosmarrëveshjet dhe tek ky teuhid lidhet çështja e dashurisë dhe urrejtjes për hirë të Allahut.

Autori: Sqarimin e plotë se shumica e ajeteve Kuranore kanë si qëllim të theksojnë dhe qartësojnë këtë parim në forma të ndryshme, me fjalë të cilat i kupton dhe njeriu më i thjeshtë.

⁴ Teuhidi i veçimit të Allahut me sundim, krijim, zotërim.

Shpjeguesi: Allahu i Madhëruar thotë:

“Adhurojeni All-llahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë”. Nisa 36.

A janë këto fjalë të paqarta? Të gjithë njerëzit e thjeshtë e kuptojnë këtë: **“Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asgjë” Nisa 36.** E kuptojnë se urdhërohen për të adhuruar vetëm Allahun dhe për tu larguar nga shirku. E kuptojnë këtë edhe nëse nuk janë të shkolluar, e kuptojnë nga gjuha e tyre. Ky është vetëm një ajet ndërkohë që Kurani është i mbushur me ajete të tilla.

Këto ajete ata i lexojnë, por nuk mendojnë rreth tyre, nga njëra anë Allahu u drejtohet duke u thënë: **“Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asgjë” Nisa 36.** Ndërsa ata thonë: O Ali! O Husejn! O Bedeui! O Tixhani! O Abdul Kadir! Çirren dhe ngrenë zërin duke thërritur o filan o fistek, ndërkohë që ai është i vdekur.

Ky njeri që bërtet dhe thërret të vdekurit ndoshta e di përmendësh të gjithë Kuranin, madje mund t'i dijë të gjitha leximet e Kuranit dhe e lexon me të gjitha rregullat, por ai kujdeset për shkronjat dhe lë mangut dispozitat e tij.

Ibn Kajim el Xheuzije thotë: Kurani i gjithi është teuhid, ai ose tregon urdhëra për t'u adhuruar Allahu, ose sjell ndalime nga ortakëria me Allahun, ose sqaron shpërblimet e njësuesve, ose dënimet e idhujtarëve, ose sqaron dispozitat e hallallit dhe haramit që konsiderohet detyrime të teuhidit, ose tregon ndodhitë e profetëve me popujt e tyre dhe ky është shpërblimi i teuhidit dhe shirkut.

Kurani është i gjithi teuhid që nga fillimi deri në fund e megjithatë këta njerëz e lexojnë Kuranin dhe akoma vazhdojnë të jenë pre e shirkut të madh. Thonë “La ilahe ila Allah” dhe nuk punojnë me të, ata janë në një luginë ndërsa Kurani dhe fjala “La ilahe ila Allah” është në një luginë tjetër, pra është thjesht fjalë që thuhet me gojë.

Nëse pyet ndonjërin prej tyre: Çfarë do të thotë “La ilahe ila Allah”? Përgjigjet: Nuk e di sepse jam i pashkolluar. Ne i themi: Pra ti thua “La ilahe ila Allah” dhe nuk ia di kuptimin, a është e pranueshme kjo për një musliman?! Thua fjalë që nuk ia di kuptimin dhe nuk preokuporesh për ta mësuar. Ose thua: I kam dëgjuar njerëzit të thonë diçka dhe unë e them si ata. Kështu do të përgjigjet munafiku në varrin e tij, kur të pyetet do të thotë: I kam dëgjuar njerëzit të thonë diçka dhe unë e thashë bashkë me

ta, pra thjesht shqiptim. Siç thotë Allahu i Madhëruar:

“Shembulli i (i thirrësit të) atyre që nuk besuan është sikurse i atij (bariut) që u lëshon britmë atyre (bagëtive) që nuk dëgjojnë tjetër vetëm se britmë e zë (e nuk kuptojnë). Ata janë të shurdhër, memecë e të verbër, ata nuk kuptojnë.”
Bekare 171.

Në këtë ajet Allahu i shëmbëlleu me bagëtitë që dëgjojnë vetëm zërin e bariut dhe tingujt dhe ecin sipas tingujve të bariut të cilat ata nuk i kuptojnë.

Autori: Më pas kur shumë prej umetit përfunduan në atë që përfunduan, shejtani ua shfaqti fenë e sinqertë në pamjen e sharjes së njerëzve të mirë dhe si lënie pas dore të detyrave ndaj tyre, ndërsa shirkun ua shfaqti në formën e dashurisë ndaj të mirëve dhe pasimit të tyre.

Shpjeguesi: Kur u thuhet mos iu lutni krijesave, mos kërkonit ndihmë prej tyre, lutuni dhe kërkonit ndihmë nga Allahu, kthehuni tek Ai dhe mos u drejtoni nga varret dhe të vdekurit, ata thonë: Ti po shan njerëzit e dashur të Allahut, ndërkohe që këta evlija tek ne respektohen dhe thërrasim në emrat e

tyre, sepse kjo është pozita e tyre. Ndërsa ti po u mvesh mangësi dhe nuk ua njeh të mirat që kanë. Me këto fjalë u përgjigjen thirrësve të teuhidit.

Ne u themi atyre: Ne i duam njerëzit e mirë, i duam evlijatë e Allahut dhe i respektojmë, por nuk u japim atë që i takon vetëm Allahut, nuk ua drejtojmë adhurimet atyre, sepse nuk u takon diçka e tillë. Ndërkohë edhe ata nuk e pranojnë këtë, pra nuk e pranojnë që të luten bashkë me Allahun, apo që dikush t'u kërkojë ndihmë në vështirësi në vend të Allahut.

Ata thonë: Ndihma që kërkojmë prej njerëzve të mirë është thjesht se ua njohim vlerat dhe i respektojmë, por kjo në të vërtetë është zbukurim prej shejtanit d.m.th. shejtanëve xhind qofshin apo dhe njerëz, pra dijetarët e të kotës që konsiderohen shejtanët njerëz që shkruajnë, flasin dhe botojnë libra për t'i ftuar njerëzit në shirk, me preteksin se ky është nderimi që u bëhet njerëzve të mirë dhe se në këtë mënyrë i njohin më shumë meritat e tyre. Ndërsa të mos u lutesh apo të mos kërkojë ndihmë prej tyre është lënie mangut në të drejtat e tyre si dhe tregon armiqësi, sic shprehen në librat e tyre.

Autori:

Parimi i dytë:

Allahu na ka urdhëruar për bashkim në fe dhe na ka ndaluar nga përçarja në të, duke e sqaruar shumë qartë këtë parim në mënyrë të atillë që ta kuptojnë edhe njerëzit e thjeshtë.

Shpjeguesi: Ky parim përmendet në Kuranin famëlartë ku Allahu i Madhëruar thotë:

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur’anin) e All-llahut.” Al Imran 103.

“E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet.” Al Imran 105.

“Vërtet ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhammed) nuk ke asnjë përgjegjësi. Çështja e tyre është vetëm tek All-llahu, Ai do t’i njohë me atë që punuan.” Enam 159.

“Ai ju përcaktoi juve për fe atë që ia kishte përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me të cilën e patëm porositur Ibrahimin,

Musain dhe Isain. (I porositëm) ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të."

Shura 13.

Për këtë arsye nuk është e lejuar që muslimanët të përçahen në fenë e tyre, përkundrazi duhet të jenë një umet i bashkuar rreth teuhidit. Allahu i Madhëruar thotë:

"Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur), kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua." Enbija 92.

Nuk i lejohet umetit të Muhamedit të përçahen në besimin e tyre, në adhurimet dhe dispozitat e fesë, njëri thotë: hallall, e tjetri: haram, nëse kjo gjë ndodh pa argument, është diçka e cila nuk lejohet. S'ka dyshim se kundërshtimet janë natyrë njerëzore siç thotë Allahu i Madhëruar:

"Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes tyre), përveç atij që e mëshiroi Zoti yt." Hud 118-119.

Kundërshtimet shmangen nëse kthehemi tek Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, alejhis-salatu ue selam, pra nëse kundërshtohemi unë dhe ti, atëherë na del si detyrë t'i kthehemi Librit të Allahut dhe Sunetit të

Profetit, alejhis-salatu ue salam. Allahu i Madhëruar thotë:

“Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë tek All-llahu (te libri i Tij) dhe tek i Dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe Ditës së fundit.” Nisa 59.

Ndërsa ajo që thuhet: Secili t’i qëndrojë medh’hebit⁵, secili t’i qëndrojë akides së tij dhe njerëzit janë të lirë në mendimet e tyre, duke kërkuar liri në çështjet e akides dhe liri në të shprehur sipas qejfit, qoftë dhe duke shprehur kufr⁶, kjo është e kota për të cilën Allahu ka ndaluar duke thënë:

“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur’anin) e All-llahut, e mos u përçani!” Ali Imran 103.

Kërkohet të jemi të një mendjeje (parimi), në mënyrë që kur të ndodhë një kundërshtim, t’i kthehemi librit të Allahut qoftë dhe në çështjet e fikhut, pra kur të kundërshtohemi t’u kthehemi argumenteve, për atë që dëshmon argumenti e marrim, ndërsa ai që nuk ia qëllon argumentit, ne nuk e marrim gabimin e tij.

⁵ Mendimit juridik në çështjet e fikhut.

⁶ Fjalë dhe vepra mohimi që të nxjerrin nga feja.

Allahu i Madhëruar nuk na ka lënë të pa udhëzuar kur të kundërshtohemi, pa një peshore e cila dallon të saktën nga e gabuara. Ai na dha Kuranin dhe Sunetin, **“Kthejeni atë tek Allahu”**, pra tek Kurani, **“Dhe tek i dërguari”**, pra tek Profeti, alejhis-salatu ue selam. Ndërsa Profeti, alejhis-salatu ue selam, ka thënë:

“U kam lënë dy gjëra, nëse kapeni fort pas tyre nuk do të humbisni: Libri i Allahut dhe Suneti im”.

Duket sikur Profeti, alejhis salatu ue selam, është mes nesh me ekzistencën e Sunetit të tij, që është i shkruar dhe i saktësuar dhe kjo është mirësia e Allahut që ia ka dhënë këtij umeti, sepse ai nuk e ka lënë umetin në humbje, përkundrazi i ka dhënë gjëra që e drejtojnë tek Allahu dhe tek rruga e drejtë. Ai që nuk e do të vërtetën dhe dëshiron që çdokush t'i mbetet medh-hebit të tij duke thënë: “Bashkohemi në gjërat e përbashkëta dhe justifikojmë njëri-tjetrin aty ku kundërshtohemi”, kjo s'ka dyshim se është fjalë e kotë.

Detyrë është të bashkohemi në librin e Allahut dhe në Sunetin e Profetit, alejhis-salatu ue selam. Në gjërat që kundërshtohemi t'i parashtrojmë tek libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, jo të justifikojmë njëri-

tjetrin duke qëndruar në kundërshtime, përkundrazi duhet t'i kthejmë gjërat tek libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, alejhis-salatu ue selam, nëse përputhet me të vërtetën ta marrim, e nëse jo, të tërhiqemi prej saj. Kjo kërkohet prej nesh që umeti mos të rrijë i përçarë.

Mbase ata që kërkojnë të qëndrojmë në kundërshtim argumentohen me hadithin:

“Kundërshtimet mes umetit tim janë mëshirë.”

Ky hadith transmetohet, por nuk është i saktë, sepse kundërshtimet nuk janë mëshirë përkundrazi janë dënim, Allahu i Madhëruar thotë:

“E mos u bëni si ata që u ndanë dhe u përçanë pasi u patën zbritur argumentet. Ata do të pësojnë një dënim të madh.” Al Imran 105.

Përçarjet i shpërndajnë zemrat dhe e coptojnë umetin, njerëzit kur përçahen e kanë shumë të vështirë që t'i dalin në ndihmë njëri-tjetrit, apo të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, përkundrazi mes tyre do ketë vetëm armiqësi dhe fanatizëm kundrejt grupacioneve dhe partive të tyre dhe nuk do të bashkëpunojnë kurrë.

Njerëzit bshkëpunojnë dhe ndihmohen atëherë kur të kapen pas Librit të Allahut dhe me këtë na ka porositur i Dërguari i Allahut duke thënë:

“Allahu i pëlqen për ju tri gjëra: Ta adhuronit e të mos i bën asnjë ortak, të kapeni të gjithë pas litarit të Allahut dhe të mos përçaheni dhe të këshilloni atë që Allahu ia ka lënë në dorë çështjen tuaj.”

Këto tri gjëra Allahu i do, kur ekzistojnë tek ne.

Ajo që është e rëndësishme në argumentim për temën tonë nga hadithi është fjala e Profetit, alejhis-salatu ue selam: **“të kapeni të gjithë pas litarit të Allahut dhe të mos përçaheni.”** Kjo nuk do të thotë se nuk ekziston kundërshtimi apo përçarja, por kjo do të thotë që kur të ndodhë përçarja dhe kundërshtimi, ta zgjidhim atë duke u kthyer tek Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, alejhis-salatu ue selam, në këtë formë mbyllen kundërshtimet dhe zënkat dhe kjo është e vërteta.

Marrja për gjykatës e Kuranit dhe Sunetit nuk ka të bëjë vetëm me rastet kur bëhet fjalë për kundërshtimet mes njerëzve në çështjet e pasurisë apo problemet e kësaj dunjaje, përkundazi ato duhet

të merren si gjykatës në çdo problem mes njerëzve, e siç dihet kundërshtimet dhe zënkat në akide (besim) janë më të forta se kundërshtimet rreth pasurisë. Kundërshtimet në adhurime dhe në çështjet e hallallit dhe haramit janë më të forta se problemet e pasurisë, prandaj kundërshtimet në pasuri janë një pjesë e kundërshtimeve që duhet ti kthejmë tek Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, alejhis-salatu ue selam.

Edhe tek sahabet kishte kundërshtime, por menjëherë ata i ktheheshin Librit të Allahut dhe sunetit të Profetit, alejhis-salatu ue selam dhe kundërshtitë e tyre merrnin fund.

Pas vdekjes së Profetit ndodhën kundërshtime mes tyre përse i takon atij që do udhëhiqte pas Profetit, alejhis-salatu ue selam, por shumë shpejt ata e mbyllën kundërshtinë që kishin mes tyre duke zgjedhur Ebu Bekrin. Ata iu bindën dhe ndoqën urdhërat e tij dhe në këtë mënyrë përçarja mori fund. Pra mes tyre ndodhnin kundërshtime, por shumë shpejt ata i ktheheshin Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit dhe kështu përfundonte kundërshtia që kishin mes njëri-tjetrit.

Kthimi tek Libri i Allahut largon smirën dhe urrejtjen, sepse askush nga muslimanët nuk e refuzon librin e Allahut. Kur i thua një njeriu hajde të tregoj fjalën e filan imami apo filan imami, ai nuk bindet, por nëse i thua: eja tek Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, alejhis-salatu ue selam, nëse ai ka besim do të kthehet e do të bindet.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Kur thirren besimtarët për të gjykuar ndërmjet tyre All-llahu dhe i Dërguari i Tij, e vetmja fjalë e tyre është të thonë: “Dëgjuam dhe respektoam!” Të tillët janë ata të shpëtuarit.” Nur 51.

Këto janë fjalët e besimtarëve, ndërsa hipokritët nëse e vërteta u përshtatet vijnë të përulur, por nëse vendimi është kundra tyre largohen dhe kthejnë shpinën siç tregon Allahu i Madhëruar.

Muslimanët nuk kanë arsye të qëndrojnë në kundërshti, qoftë në bazat apo degëzimet e sheriatit, sepse të gjitha këto zgjidhen me librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit, alejhis-salatu ue selam.

Por nëse një çështje nuk ka qartësi, dhe secili prej dy muxhtehidëve ka njëfarë të drejte në arsyetimin e tij dhe shkon deri aty sa nuk gjendet ndonjë faktor që e

bën fjalën e tjetrit më të fortë, në këtë rast nuk qortohet ai që merr fjalën e njërit prej këtyre dy palëve. Prandaj edhe dietarët kanë thënë: Nuk ka qortim në çështjet e ixhtihadit, pra në çështjet ku nuk është e qartë se me cilën palë qëndron argumenti .

Autori : Gjithashtu na ndaloj të bëhemi si ata që u përçanë, u kundërshtuan e si rrjedhojë u shkatërruan. Ai i urdhëroi besimtarët që të bashkohen në fe dhe i ndaloj nga përçarja në të. Këtë e sqaron edhe më shumë Suneti, ku përmenden trasmetime nga më të habitshmet rreth këtij problemi. Por më pas shkoi puna deri aty, sa që përçarja në bazat dhe degët e fesë të konsiderohet dije dhe njohje e fesë.

Shpjeguesi: Kur qëndruan në kundërshtime u shkatërruan, u përplasën mes tyre, madje edhe u vranë. Kështu qëndron puna me njerëzit që kundërshtohen, ndryshe nga njerëzit e bashkuar që janë forcë, sepse e kanë larguar çdo lloj zillie nga zemrat e tyre.

“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty, as të asaj para teje) derisa nuk të zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes

tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht.” Nisa 65.

Nuk i kënaq njerëzit e as nuk e largon kundërshtimin përveçse kthimi tek Libri i Allahut dhe Suneti i Profetit, alejhis-salatu ue selam.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Ai ju përcaktoi juve për fe atë që i pati përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të.” Shura 13.

Pra mos u bëni secili me një fe të veçantë, sepse feja është një dhe nuk duhet të ketë përçarje.

Është e vërtetë se përcillen nga Profeti, alejhis-salatu ue selam, shumë hadithe që nxisin për bashkim dhe kritikojnë përçarjen dhe kundërshtimin. Siç është p.sh. hadithi ku Profeti, alejhis-salatu ue selam, thotë: ***“Ai që do të jetojë nga ju do shohë shumë kundërshtime, prandaj u këshilloj të kapeni pas Sunetit tim dhe sunetit të prijësave të drejtë.”***

Por tek njerëzit që erdhën më pas, fatkeqësisht, përçarja dhe kundërshtimi në bazat dhe degët e fesë konsiderohet dije dhe fikh, ndërkohë që kërkohet e kundërta : bashkimi në fe, sepse kjo është dija e plotë.

Ata thonë: Kundërshtimet dhe dhënia e lirisë së njerëzve duke mos ua mbyllur rrugët kjo është dija. Ndërsa ne u themi: fikhu i vërtetë është të mblidhemi rreth librit të Zotit dhe Sunetit të Profetit, alejhis-salatu ue salam. Disa prej tyre thonë: prej gjerësisë së Islamit është që kur dikush ta ndalojë diçka, duhet të gjejmë dikë tjetër që e lejon atë. Në këtë mënyrë i konsiderojnë njerëzit sikur janë ligjvënës, dmth sipas tyre nëse dikush thotë kjo është hallall, ajo gjë bëhet hallall edhe nëse është haram në Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit, alejhis-salatu ue salam.

Ne themi: t'i kthehemi librit të Allahut, për cilindo që dëshmon Kurani të vërtetë, ne e marrim dhe e pranojmë, e nëse e gjykon si diçka gabim ne e lëmë. Kjo kërkohet prej nesh.

Autori: E megjithatë çështja shkoj deri aty sa që urdhërimi për t'u bashkuar në fe, konsiderohej thënie vetëm e zindikut apo të çmendurit.

Shpjeguesi: Për atë i cili urdhëron për bashkim dhe ndalon nga përçarja thonë : ky është i dalë nga feja Islame, zindik, sepse hedh poshtë fjalë e imamllarëve. Realisht ne nuk i hedhim poshtë fjalët e dijetarëve, përkundrazi ne vetëm i ballafaqojmë me librin e Allahut. Ne nuk jemi urdhëruar që të ndjekim njerëzit, përkundrazi jemi urdhëruar të ndjekim Kuranin dhe Sunetin, kjo është e vërteta. Pra nuk jemi urdhëruar të ndjekim filanin apo fistekun dhe se Allahu nuk na ka lënë t'u mbështetemi mendimeve dhe ixhtihadeve tona, përkundrazi ai solli Librat, dërgoi Profetët. Prandaj nëse i kthehemi Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit largohen përçarjet, kundërshtimet dhe jemi të një fjale të vetme.

A e dini se deri në një kohë të afërt në xhaminë e Qabes kishte katër mihrabe⁷, çdo medh'heb falej me imam më vete dhe me pasuesit e tij dhe kjo ndodhte ngjitur me Qaben, deri në kohën kur Allahu mundësoi dikë që i bashkoi të gjithë rreth një imami dhe u largua fal Zotit kjo dukuri e shëmtuar.

E gjithë kjo ndodh për shkak të medh'hebeve dhe ndjekjes së mendimeve, derisa edhe namazin e

⁷ Vendi ku qëndron imami gjat faljes.

përçanë kështu që hanefiu nuk falej pas hanbeliut, ndërsa hanbeliu nuk falej pas shafiut dhe nuk faleshin në një kohë, njëri falej në kohën e parë ndërsa tjetri më vonë, sepse filani mendonte se duhej vonuar, ndërsa tjetri mendonte se duhej shpejtuar dhe kështu donin ti kënaqnin të gjithë njerëzit.

Këtë dukuri e kemi gjetur edhe në disa vende të tjera dhe akoma vazhdojnë ta praktikojnë derisa edhe të xhumanë nuk e falin në një kohë. Disa e falin afër namazit të ikindisë, sepse filani ka thënë kështu, e nëse dikush do ta falë herët shkon dhe e fal tek filani, e kush do ta vonojë shkon e fal tek tjetri. Tek ne falenderojmë Allahun, nën hijen e kësaj thirrje të bereqetshme e kthyen xhaminë e Qabes siç ka qenë më parë, në kohën e selefëve të mirë duke u falur të gjithë në një kohë dhe pas një imami.

Autori:*Parimi i tretë:*

***P*rej bashkimit të plotë është dëgjimi dhe bindja ndaj atyre që na udhëheqin, edhe nëse ai është rob nga Etiopia. Këtë parim Allahu e sqaroi mjaftueshëm në shumë forma, si nga ana legjislative ashtu dhe nga ligji universal.**

Shpjeguesi: Atëherë, parimi i tretë është bindja ndaj udhëheqësit Musliman, sepse nuk mund të ndodhë bashkimi vetëm se me bindjen ndaj udhëheqësit, pra nuk ka bashkim pa imam (prijës), dhe nuk ka imam pa bindje dhe dëgjim.

Allahu e ka bërë mëshirë ekzistencën e prijësit të muslimanëve për ta, për të zbatuar vendimet dhe dispozitat, për të urdhëruar për mirë dhe ndaluar nga e keqja, si dhe për t'i dalë në ndihmë atij që i është bërë padrejtësi kundrejt të padrejtës si dhe për ruajtjen e rendit, sigurisë dhe qetësisë.

Kjo pra është prej mëshirës së Allahut. Kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut, sahabët nuk e varrosën atë derisa zgjodhën prijësin e tyre, sepse i frikësoheshin kundërshtimeve dhe mosmarrëveshjeve. Ata e dinin

se nuk mund të rrinin pa udhëheqës qoftë dhe një natë, sepse kjo është prej gjërave të domosdoshme të fesë.

E gjithë kjo nuk mund të arrihet pa dëgjim dhe bindje ndaj udhëheqësit musliman. Allahu i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat, bindjuni All-llahut, bindjuni të Dërguarit dhe përgjegjësve nga mesi juaj.” Nisa 59.

Pas bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit, alejhis-salatu ue selam, vjen bindja ndaj prijësit. Fjala **“nga ju”** dmth nga **muslimanët**, që do të thotë se kushtëzohet që prijësi të jetë Musliman. Për këtë Profeti, alejhis-salatu ue selam, thotë:

“U porosis për devotshmëri ndaj Allahut, të dëgjoni dhe të bindeni ndaj prijësit edhe nëse iu udhëheq një skllav. Kjo sepse ata që do jetojnë pas meje do të shohin shumë mospajtime, prandaj kapuni pas Sunetit tim dhe sunetit të prijësave të drejtë pas meje. Kapuni fort pas tyre dhe shtrëngohuni me dhëmballë”.

Ky pra është parimi i tretë: dëgjimi dhe bindja, dëgjoni dhe binduni edhe nëse u udhëheq një skllav.

Për këtë arsye nuk mund të ndodhë bashkim mes muslimanëve vetëm nëse ka prijës musliman, edhe nëse nuk është arab madje edhe nëse është në pronë të dikujt (skllav).

Autori: Më pas ky parim filloi të mos njihej tek shumica e atyre që pretendojnë dijen, ndaj për rrjedhojë si mund të gjente zbatim?!

Shpjeguesi: Ky parim u bë i panjohur tek shumica e atyre që mbahen të dijshtëm duke e neglizhuar çeshtjen e bindjes, vlerën që ajo ka dhe rëndësinë që bart, pra kur kjo ndodh me të diturit, atëherë si do të jetë gjendja me njerëzit e thjeshtë?! Nuk ka dyshim se ata do të jenë më të painformuar rreth saj.

Në këtë lloj situatë ku sundon injoranca, tek këta njerëz konsiderohen trima që urdhërojnë për të mirë dhe ndalojnë nga e keqja, e që nuk i frikësohen askujt veç Allahut, ata të cilët rebelohen kundra prijësit të Muslimanëve duke mos iu bindur atij dhe thërreasin për revolucione kundra udhëheqësve muslimanë, vetëm për shkak se ndodh tek ata ndonjë gabim apo gjynah që nuk arrin nivelin e kufrit.

Në këtë mënyrë i kanë bërë vendtubimet, seminarët dhe ligjeratat mjete vetëm për të gjetur të metat e udhëheqësve, për ti fryrë dhe ekzagjeruar ato, derisa kjo çon në përçarje dhe i largon njerëzit nga bindja ndaj udhëhqësit, e në këtë mënyrë humbet siguria, destabilizohet situata dhe derdhen gjakrat. Kjo çon në një gjendje më të keqe se sa durimi që do të tregonin në bindjen ndaj udhëhqësit të prishur, që bën gjynahe të cilat nuk janë kufër të qartë, për të cilin të kenë argument të qartë nga Allahu i Madhëruar.

Autori:*Parimi i katërt:*

Sqarimi i rëndësisë së dijes dhe dijetarëve, fakihut dhe fukahave, si dhe sqarimi i gjendjes së atyre që mundohet t'u përngjajnë dijetarëve, por nuk janë prej tyre.

Shpjeguesi: Ky është një parim madhështor, sepse sqaron se cilën dituri kemi për qëllim. Pra dija e vërtetë është dija e sheriatit e bazuar mbi Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit, alejhis-salatu ue selam. Kjo është dija e dobishme, ndërsa dituritë rreth çështjeve të kësaj dunjaje si zanatet, industritë, mjekësia, etj. nuk mund të quhen dije absolute pa u vënë një kufizim (dije e dobishme në atë fushë).

Pra, kur thuhet dije e vlefshme, është për qëllim dija fetare ndërsa njohuritë e tjera që kanë të bëjnë me zanatet, prodhimitarinë, mjekësinë etj, janë njohuri të lejuara, por që duhen specifikuar në emërtimin e tyre si dituri .

Mund të thuhet dituria e inxhinierisë, mjekësisë, edhe pse sot është për të ardhur keq, kur tek njerëzit thuhet dije, menjëherë mendja shkon tek

dija bashkëkohore dhe kur dëgjojnë diçka nga Kurani apo Hadithi, thonë për këtë dëshmon edhe shkenca bashkëkohore.

Termi *Dije* sot njihet dhe i dedikohet zanateve, industrisë dhe mjekësisë. Ndërkohë që kjo dije mund të jetë injorancë dhe në shumë raste është e përzier me gabime, sepse është përpjekje njerëzore, ndryshe nga dija fetare që ka ardhur nga Allahu të cilës:

“Nuk mund t’i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit.” Fusilet 42.

Allahu i Madhëruar thotë:

“All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është i Gjithëpushtetshëm, Mëkatfalës.” Fatir 28.

Pra bëhet fjalë për dijetarët e sheriatit, ndërsa të diturit e inxhinierisë, industrisë, shpikjeve dhe mjekësisë, mund të ketë prej tyre që nuk e njohin detyrimin që kanë ndaj Allahut, nuk e njohin Allahun, por edhe nëse e njohin, e njohin Atë në mënyrë të mangët, ndërsa ata që e njohin Allahun

ashtu siç duhet janë dijetarët e sheriatit, sepse Allahu i Madhëruar thotë:

“All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është i Gjithëpushtetshëm, Mëkatfalës.” Fatir 28.

Dijetarët janë ata që e njohin Allahun me emrat dhe cilësitë e Tij, e njohin detyrimin karshi Tij dhe kjo nuk arrihet nëpërmjet dijes së mjekësisë apo inxhinierisë. Me atë dije njeriu mund të realizojë vetëm teuhidin rububijeh, ndërsa teuhidi uluhijeh⁸ realizohet vetëm nëpërmjet dijes fetare.

Në këtë parim, autori sqaron dhe në lidhje me atë grup njerëzish që mundohen të hiqen sikur të jenë prej dijetarëve, ndërkohë që nuk kanë asnjë lloj bagazhi në dije. Mundohet të shfaqë veten si i ditur dhe t’u ngjasojë njerëzve të dijsëm ndërkohë që nuk posedon asgjë nga dija. Dëmi i këtij njeriu është shumë i madh, në radhë të parë ndaj vetes dhe më pas ndaj të tjerëve, sepse ai flet për Allahun pa dije dhe i humbet njerëzit pa dije. Allahu i Madhëruar thotë:

⁸ Teuhidi i veçimit të Allahut me adhurim.

“E kush është më mizor se ai që trillon gënjeshtër për All-llahun dhe prej kësaj t’i humbë njerëzit në mungesë të dijes. All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë mizorët.” Enam 144.

Në kohët e mëhershme thuhej: Këtë botë e prishin katër kategori njerëzish: gjysëm dijetari, gjysëm gjuhëtari, gjysëm mjeku, gjysëm mendimtari. Njëri çrregullon vendin, tjetri çrregullon gjuhën, tjetri çrregullon shëndetin, ndërsa tjetri çrregullon fenë.

Autori:

Allahu i Madhëruar e sqaroi këtë parim në fillim të sures el Bekare, që kur fillon me fjalën:

“O bijtë e Israilit, kujtoni (jini mirënjohës për) të mirat e Mia, të cilat ua dhurova juve dhe zbatoni premtimin që ma keni dhënë Mua...” Bekare 40

deri tek ajeti 122 para se të përmendë Ibrahimin, alejhi selam kur thotë: “o bijtë e Israilit”. Këtë e sqaron edhe fakti se shumë hadithe flasin për këtë (parim) në formë të qartë që të jetë e kuptueshme edhe për njeriun më të thjeshtë.

Shpjeguesi: Allahu i Madhëruar në suren el Bekare ka zbritur shumë ajete që flasin për pasardhësit e

Israilit për t'ua kujtuar mirësitë e Tij. Në këto ajete Ai i urdhëroi që të ndjekin profetin Muhamed, alejhis-salatu ue selam, të cilit ia njohin profetësinë dhe shpalljen në librat e tyre dhe për të cilin kanë përgëzuar profetët e tyre. Ai e filloi me fjalën e Tij duke thënë:

“O bijtë e Israilit, kujtoni (jini mirënjohës për) të mirat e Mia, të cilat ua dhurova juve dhe zbatoni premtimin që ma keni dhënë Mua. Unë e zbatoj atë që u premtova dhe të më keni frikë vetëm Mua.” Bekare 40.

dhe e mbylli me fjalën e Tij duke thënë:

“O bijtë e Israilit, kujtoni të mirat e Mia që ua dhurova, që ju dallova mbi njerëzit e tjerë (të asaj kohe).” Bekare 122.

“Dhe ruajuni një Dite në të cilën askush nuk do të mund ta ndihmojë tjetrin për asgjë , nuk pranohet prej askujt kompensim, nuk do t'i bëjë dobi askujt ndonjë ndërmjetësim dhe as që do të ndihmohen (mëkatarët).” Bekare 123.

Pas kësaj ai përmendi Ibrahimin, alejhis selam, duke thënë:

“Përkujto (O i dërguar) kur Zoti i vet, Ibrahimin e provoi me disa obligime, e ai i përmbushi ato.”

Të gjitha këto ajete nga i pari deri tek i fundit flasin për bijtë e Israilit, për t’iu kujtuar atyre mirësinë e Allahut me dërgimin e profetëve, zbritjen e librave dhe se detyra e tyre është t’i besojnë të dërguarit të Allahut, Muhamedit, alejhi salatu ue selam.

Beni Israilët janë bijtë e Jakubit dhe Israili është Jakubi, ndërsa ata janë pasardhësit e tij, dymbëdhjetë pasardhës. Çdo fëmijë i tij bëri një fis dhe çdo fis konsiderohej **sibt**⁹, ashtu siç ishin fiset arabe. Allahu i Madhëruar thotë:

“Ne i ndamë ata (popullin e Musait) në dymbëdhjetë grupe fisesh.”Arafë 160.

Është e vërtetë se janë transmetuar shumë hadithe që nxisin për kërkimin e dijes, si dhe sqarimin e dijes së dobishme nga ajo e padobishme. Nëse kthehesh tek libri “Bejan fadli el ilmi ue ehlihi”¹⁰ të Ibn AbdulBerrit, do të gjesh në të shumë nga këto që thamë dhe të tjera.

⁹ Familje të mëdha.

¹⁰ “Sqarim i rëndësisë së dijes dhe dijetarëve”, libri është i përkthyer në shqip.

Autori: Më pas dija u shndërrua në gjërat më të huaja, e kështu dija dhe fikhu i vërtetë u konsideruan bidatet dhe humbjet dhe e vetmja zgjidhje që u kishte mbetur, ishte mveshja e të vërtetës me të kotën.

Ai person i cili flet me dijen të cilën Allahu e obligoi mbi krijesat, konsiderohej zindik ose i çmendur. Ndërsa ai që e refuzon atë dituri dhe që tërheq vërejtjen prej saj, konsiderohet fakihu i dijshtëm.

Shpjeguesi: Tek disa të mëvonshëm dija dhe fikhu konsiderohej bidati dhe gjërat e humbura. Ata e lanë dijen e saktë të bazuar mbi Llibrin e Allahut dhe Sunetin e Profetit, alejhi salatu ue selam, ndërsa dije tek ata konsiderohen fjalët e njerëzve, tha filani e tha fisteku.

Disa prej tyre thonë: Varri filan të bën dobi për këtë problem, dhe në filan tokë dikush ka parë këtë ëndërr, kjo është dija e tyre. Ose kërkojnë ato hadithe të cilat janë varrosur nga dijetarët e hadithit sepse janë të trilluara, ndërsa këta i marrin, i konsiderojnë të sakta, ua zbukurojnë senedet¹¹ dhe i shfaqin duke thënë: këto janë hadithe të sakta,

¹¹ Rugën e transmetimit.

ndërkohë që i braktisin ato hadithe të mirënjohura që përcillen tek Buhariu dhe Muslimi, apo katër Sunenet dhe Musnedet e konsiderueshme, pra i braktisin sepse nuk janë në anën e tyre.

Është detyrë që të bëhet i qartë dallimi mes të kotës dhe së drejtës, të bëhet ndarja mes tyre, sepse nëse bëhet bashkim mes tyre, atëherë ky është mashtrimi dhe shkelja e amanetit të dijes ndaj njerëzve.

Tek ata, dija të cilën Allahu e lavdëroi, konsiderohet injorancë, ndërsa ai që flet me këtë dije e quajnë të çmendur sepse thonë: dija që Allahu obligoi na ndryshon traditën me të cilin njerëzit janë ambientuar, ndryshon fenë e baballarëve tanë.

Ai që shkruan kundër dijes së dobishme dhe mbron dijen e padobishme dhe e përhap mes njerëzve thonë për të: ky është fakihu, ky është dijetari, ndërsa ai që përhap dijen e saktë thonë për të: ky nuk bën, ky është injorant, ky kërkon që t'i ndajë njerëzit, ne duam t'i bashkojmë e jo t'i ndajmë, (pra ti bashkojnë qoftë dhe në të kotë) dhe nuk duam përçarje që dallon midis të kotës dhe së vërtetës, të mirës dhe së keqes. Kjo që duan është e pamundur, sepse nuk arrihet bashkimi rreth të kotës, përkundrazi uniteti realizohet kur njerëzit bashkohen rreth të vërtetës.

Autori:*Parimi i pestë:*

Sqarimi që Allahu ka bërë rreth evlijave (robërit që i do), dallimi mes tyre dhe atyre që mundohen t'u përngjajnë e që në të vërtetë janë armiq të Allahut, dyfytyrësh dhe mëkatarë. Për këtë mjafton një ajet i vetëm në suren Al Imran, fjala e Allahut ku thotë:

“Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t'u dojë, t'u falë mëkatet tuaja, sepse All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë.” Al Imran 31.

Shpjeguesi: Po, ky është një parim i madh, dallimi mes evlijave të Allahut dhe evlijave të shejtanit. Kjo sepse njerëzit e së kotës filluan t'i quajnë evlijatë e shejtanit, evlija të Allahut dhe kjo çështje u bë e paqartë tek njerëzit.

Për këtë arsye Shejhul Islam ibn Tejmije shkroi një libër të dobishëm të cilin e titulloi: “Dallimi mes evlijave të Rrahmanit dhe evlijave të shejtanit”¹².

¹² Libri është i përkthyer në shqip.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Ta dini se të dashurit e Allahut (evlijatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje”.

Më pas Allahu tregoi cilësitë e tyre duke thënë: ***“(Janë ata) Të cilët besuan dhe ishin të devotshëm.”*** Junus 62-63.

Këta janë të dashurit e Allahut të cilët bashkuan mes besimit dhe devotshmërisë, mes dijes së dobishme dhe punëve të mira. Por nuk mund të jetë evlija i Allahut ai që del nga normat e sheriatit dhe ndryshon fenë e Tij, thërret të tjerët për adhurimin e varreve, tyrbeve etj. Në fakt ky është i dashur i shejtanit, sepse kurrë nuk mund të jetë evlija një magjistar apo fallxhor i cili u tregon njerëzve çudira magjie dhe thotë: Këto janë mrekulli, e në realitet ato nuk janë vetëm se mashtrime shejtani.

Të duash Allahun, është prej adhurimeve më të mëdha. Shenja dalluese e dashurisë tënde për Allahun është ndjekja e profetit Muhamed, alejhi salatu ue selam. Ai që nuk e ndjek Profetin, alejhi salatu ue selam, nuk është i dashur i Allahut, e as që e do Allahun. Këta njerëz të prishur thonë: Nuk

mund të jesh i dashur i Allahut derisa të largohesh nga bindja ndaj Profetit, alejhi salatu ue selam, pra mendojnë se *el uilajeh* arrihet duke kundërshtuar rrugën e Profetit, alejhi salatu ue selam dhe duke u mbështetur në gjërat e kota dhe në sajesa.

Ata thonë: Ne e adhurojmë Allahun sepse e duam, nuk e adhurojmë nga frika që kemi për zjarrin e as nga nevoja që kemi për xhenetin, pra e adhurojmë sepse e duam.

U thuhet atyre: E doni atë sipas cilës mënyrë? Sipas mënyrës profetike apo në ndonjë formë tjetër? Ta dini se nuk e do Allahun vetëm se ai që ndjek rrugën e profetit, alejhi salatu ue selam dhe kjo është pika ndarëse mes evlijave të Allahut dhe evlijave të shejtanit.

Autori:

Ajeti tjetër në suren Maide ku Allahu i Madhëruar thotë:

“O ju që besuat! Kush largohet prej jush nga feja e vet (i bën dëm vetes) s’ka dyshim se All-llahu do ta sjellë një popull që Ai e do atë (popull) dhe ata e duan Atë (Zotin)”Maide 54.

Dhe një ajet tjetër në suren Junus ku Allahu i Madhëruar thotë:

“Ta keni të ditur se të dashurit e All-llahut (evlijatë) nuk kanë frikë (në botën tjetër) e as kurrfarë brengosje? Të cilët besuan dhe ishin të devotshëm.” Junus 62-63.

Këto janë cilësitë e evlijave të Allahut, ata e duan Allahun dhe Allahu i do ata, “të përrulur me besimtarët dhe të ashpër ndaj jobesimtarëve”, pra i duan besimtarët, kanë dashuri për besimtarët dhe urrjetje për idhujtarët. “Luftojnë në rrugën e All-llahut dhe nuk i frikësohen kërcënimit të asnjë kërcënuesi. Kjo (cilësi e atij populli) është dhuratë e All-llahut që i jep atij që do. All-llahu është dhurues i madh, i gjithëdijsëm.” Maide 54.

Shpjeguesi: Këto janë katër cilësi të cilat i posedojnë evlijatë e Allahut, ndërsa ata që urdhërojnë për adhurimin e dikujt tjetër përveç Allahut dhe u luten varreve, të vdekurve dhe tyrbeve duke i quajtur mrekulli të Allahut, ato që në të vërtetë janë mashtrime të shejtanit, këta në fakt janë shenjat e armiqve të Allahut.

Nga këto tri ajete përfitohen cilësitë e evlijave të Allahut, i pari në suren Al Imran, i dyti në suren Maide, dhe i treti në suren Junus. Në këto ajete tregohen shenjat e miqve të Allahut, ai që cilësohet me këto shenja konsiderohet i dashur i Allahut, ndërsa ai që i kundërshton konsiderohet i dashur i shejtanit.

Autori:

Më pas tek shumica e atyre që pretendojnë dijen dhe që pretendohet që të udhëzojnë njerëzit dhe të ruajnë fenë, shprehen duke thënë se evlijatë patjetër duhet të braktisin rrugën e Profetëve, sepse ai që i ndjek ata (profetët) nuk është prej tyre (evlijave). Shprehen se duhet të braktiset xhihadi dhe se ai që lufton nuk është prej tyre (evlijave). Gjithashtu kërkojnë me ngulm braktisjen e besimit dhe devotshmërisë, sepse ai që lidhet me besimin dhe devotshmëinë nuk është prej tyre (evlijave). O Zoti ynë kërkojmë mëshirë nga ana jote, vërtet Ti je që e dëgjon lutjen.

Shpjeguesi: Nëse del jashtë sheriatit atëherë ata e konsiderojnë njohës të Allahut, i cili ka mbërritur tek Ai dhe nuk ka nevojë që të referohet tek rruga e

profetëve, përkundrazi ai i merr gjërat direkt nga Allahu.

Prandaj thonë: Ju e merrni fenë me zinxhirë transmetuesish nga të vdekurit, pra nga senedet e hadithit, ndërsa ne e marrim fenë nga Ai që nuk vdes kurrë, pretendojnë se e marrin direkt nga Allahu i Madhëruar.

Ai që merr nga Profeti, alejhi salatu ue selam nuk konsiderohet evlija tek ata, pra nuk e quajnë të tillë vetëm se atë që del jashtë sheritatit të Profetit, alejhi salatu ue selam.

Ndërsa sot nuk mund të quhet velij dikush tjetër, përveç ai të cilit i ndërtohet mbi varrin e tij ndonjë kupolë ose ndonjë xhami, ndërsa ai që varroset sipas sunetit dhe nuk i ndërtohet asgjë, sipas tyre nuk quhet velij, edhe pse mund të jetë prej njerëzve më të mirë.

Gjithashtu, sipas tyre, veliu ka dhe veshje të vecantë me çallmën dhe pardesynë me formë dhe ngjyrë të veçantë, ndryshe nga të tjerët. Ibn Kajimi, Allahu e mëshiroftë, thotë: Evlijatë e Allahut nuk kanë ndonjë shenjë me të cilën mund të dallohen, ata janë si të

gjithë njerëzit dhe nuk bien në sy, ndërsa Profeti, alejhi salatu ue selam, thotë:

“Mund të ketë njerëz të pluhurosur dhe të shpupurisur, e që dëbohen nga portat e njerezve (në shenjë nënçmimi), por nëse betohen në Allahun (i luten me ngulm për diçka), Allahu ua përmbush betimet”.

Këto janë cilësitë e evlijave, ata nuk e shfaqin veten, përkundrazi fshihen për shkak të sinqeritetit që kanë për Allahun. Pra prej cilësive të tyre është thjeshtësia, fshehja dhe mos rënia në sy.

Autori:*Parimi i gjasktë:*

Refuzimi i dyshimit që hedh shejtani tek njerëzit për t'i shtyrë drejt braktisjes së Kuranit dhe Sunetit, duke ndjekur mendimet dhe tekat e ndryshme që përçajnë. Ky dyshim është pretendimi se: Kuranin dhe Sunetin nuk e kupton vetëm se ai i cili është Muxhtehid.

Shpjeguesi: Ky është parimi i fundit, por njëkohësisht mjaft i rëndësishëm. Ata thonë: Ne nuk i dimë domethëniet e Kuranit dhe Sunetit dhe nuk mund t'i dimë, atë e kuptojnë vetëm dijetarët e mëdhenj (Muxhtehidët).

Ne u themi: Në Kuran, ka gjëra shumë të qarta, të cilat i di çdo njeri i thjeshtë dhe çdo njeri i ditur dhe me këto ajete ngrihen argumentet ndaj njerëzve. Po ka gjëra që nuk i dinë vetëm se dijetarët, gjithashtu ka gjëra që i di vetëm Allahu i Madhëruar.

Është e vërtetë që ka gjëra në Kuran dhe Sunet që i dinë vetëm muxhtehidat absolutë, e megjithatë ka shumë gjëra të tjera që i kuptojnë edhe njerëzit e

thjeshtë, gjithashtu edhe ai njeri që ka deri diku njohuri, siç është fjala e Allahut ku thotë:

“Adhurojeni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asgjë”. Nisa 36

dhe:

“Sepse ai që i përshkruan Zotit shok, All-llahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) atij xhennetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës.” Maide 72

dhe:

“Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë).” Isra 32

dhe:

“Juve u janë ndaluar (t’i hani): ngordhësirat...” Maide 3

dhe:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t’i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre.” Nur 30.

Të gjitha këto janë gjëra të qarta që i kupton çdokush kur i dëgjon.

Autori:

(Ata pretendojnë duke thënë) Ndërsa Muxhtehidi është ai i cili ka këtë e atë cilësi, kushte që ndoshta nuk ekzistonin të përmbushura plotësisht as tek Ebu Bekri dhe Umeri, radijaAllahu anhum.

Shpjeguesi: Pra vendosin kushte përse i takon muxhtehidit absolut, kushte që nuk i plotësojnë njerëz edhe më të mirë, si shembulli i Ebu Bekrit apo Umerit. Këto kushte s'ka dyshim se i kanë vënë nga vetja e tyre.

(Shembuj të ajeteve të kuptueshme:)

Allahu i Madhëruar thotë:

“A nuk e meditojnë ata (me vëmendje) Kur'anin?” Nisa 82,

ky ajet i përfshin të gjithë muslimanët. Të gjithë dinë nga Kurani atë që Allahu ia ka lehtësuar, njeriu i thjeshtë kupton aq sa mundet, njeriu i shkolluar merr aq sa mundet, ndërsa i thelluari në dije merr aq sa ka mundësi.

Allahu i Madhëruar thotë:

“Ai e lëshon ujin (shiun) nga qielli e sipas madhësisë së tyre rrjedhin lumenj.” Rad 17.

Pra çdo luginë merr nga shiu pjesën e vet, e njëjta gjë vlen për dijen të cilën e zbriti Allahu ku cdo zemër merr prej saj pjesën e vet. Zemra e njeriut të thjeshtë, atij të shkolluar dhe atij që është më i thelluar në dije, secili merr pjesën e tij për aq zgjuarsi sa i ka dhënë Allahu.

Prandaj të thuash se Kuranin nuk e kupton vetëm se muxhtehidi absolut, kjo fjalë nuk është e saktë.

Gjithashtu thonë: Përpjekja për të kuptuar Kuranin është detyrë e pamundur.

Ndërsa kushtet të cilat i përmendin dijetarët kur thonë: Kushte që duhet të jenë të pranishme tek ai që jep fetva, këtu kanë për qëllim muxhtehidin absolut dhe nuk kanë për qëllim që këto kushte të jenë të pranishme tek cilido që kërkon të meditojë në librin e Allahun dhe do të përfitojë prej tij.

Shtoji kësaj edhe faktin tjetër se ato janë kushte që duhet t'i ketë ai i cili kërkon të nxjerrë dispozita që nuk janë shumë të qarta, që kërkojnë studime të hollësishme, por nuk janë kushte për të kuptuar çështje të qarta siç është teuhidi, shirku, detyrimet dhe ndalimet e qarta.

Autori:

(Sipas tyre) nëse njeriu është në një gjendje të tillë, atëherë le të largohet prej tyre përfundimisht, ndërsa ia që kërkon udhëzimin prej tyre (Kuranit dhe Sunetit), ose është zindik ose i çmendur, sepse e ka të vështirë të kuptojë Kuranin dhe Sunetin. Subhanallahi ue bihamdihi, sa shumë e ka sqaruar Allahu këtë dyshim të mallkuar , si me tekste fetare ashtu dhe me parime universale, me urdhëresa dhe fakte konkrete, në forma të ndryshme deri në atë pikë sa që është bërë prej parimeve domosdoshmërisht të njohura,

“E megjithatë shumica e njerëzve nuk e dinë.”

“Për Zotin tashmë ka marrë fund vendimi kundër shumicës së tyre, prandaj ata nuk besojnë. Ne u kemi varur në qafat e tyre pranga të cilat u arrijnë deri në nofulla, prandaj ata mbesin me koka lart. Ne u kemi vënë edhe para tyre pengesë edhe mbrapa tyre pengesë dhe ua kemi mbuluar sytë, prandaj ata nuk shohin. Dhe për ata është e njëjtë, ua tërhoqe vërejtjen apo nuk ua tërhoqe, ata nuk besojnë. Ti ia tërheq vërejtjen vetëm atij që e pason Kur'anin dhe i frikësohet Mëshiruesit edhe kur është vetëm (larg syve të njerëzve), pra

përgëzoje atë me falje dhe shpërblim të mirë.”
Jasin 7-11.

*Shpjeguesi:*Këto ajete janë për ata që ua kthejnë shpinën ajeteve të Allahut dhe fjalëve të Profetit, alejhis salatu ue selam, ndërsa në fund të tij jepet përgëzimi për atë që e ndjek Kuranin dhe i frikësohet Mëshiruesit, ky pra është dallimi mes dy grupimeve.

Autori:

Dhe në mbyllje falënderimi i përket Allahut Zotit të botëve, paqja dhe nderimet e Allahut qofshin mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij deri në ditën e gjykimit.

*Shpjeguesi:*Ai e mbylli këtë broshurë me fjalët që e filloi, pra me falënderimin ndaj Allahut dhe salavatet ndaj Profetit, alejhis salatu ue selam. Kjo është prej metodës së mirë në hartimin e shkrimeve, sepse fillon dhe mbaron me lëvdata ndaj Allahut të Madhëruar.

Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të dërguarin e Tij, mësuesin e të mirës dhe thirrësin për tek Allahu, paqja qoftë mbi të, familjen, shokët dhe të gjithë ata që e ndjekin deri në ditën e Gjykimit. Në përfundim, të gjithë falënderimet dhe lëvdatat i takojnë Allahut Zotit të botëve.

Përmbajtja

Parathënie.....	3
Parimi i Parë.....	8
Parimi i Dytë.....	17
Parimi i Tretë.....	30
Parimi i Katërt.....	34
Parimi i Pestë.....	42
Parimi i Gjashtë.....	49